



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2025:007874

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06905945

P.nr.18/25

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit A.K., nga fshati ..., komuna Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Lajmërimi apo kallëzimi i rremë* nga neni 382 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.552/24, e datës 16.01.2025, më datë 26.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë themelore në Mitrovicë PP.II.nr.552/24, e datës 16.01.2025, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI: A.K., nga i ati I..., e ëma H..., e vajzërisë P..., data e lindjes..., në fshatin S... komuna e Vushtrrisë ku edhe tani jeton, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër të identifikimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 25.03.2024, rreth orës 10:30 në Vushtrri, saktësisht në stacionin policor në Vushtrri kishte bërë lajmërim të rremë tek personat zyrtar duke nxitur policinë si organ procedural që të ndërmerr veprimet hetimore fillestare për zbulimin e kryesit të veprës dhe rrethanave në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, në atë mënyrë që i pandehuri para 3-4 viteve kishte blerë një veturë nga një tregtar e cila kishte rezultuar si hipotekë dhe për këtë kishte paguar 700€ dhe meqenëse atyre u kishte borgj atëherë në shenjë respekti u kishte kthyer 1000€ për vonesën, mirëpo personi me nofkën “Tarzani” sipas ti kishte kanosur me fjalët “Çka po don me këto? Deri tash tu kan bo 50 mij”, pastaj i pandehuri vjen në stacion policor dhe konfirmon që krejt çka ka deklaruar nuk ishte e vërtetë dhe këtë e ka bërë vetëm nga ndikimi i shoqërisë së keqe.

- Me këtë ka kryer veprën penale Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 382 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 449, dhe 495 të KPPK-së,

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË në shumën prej pesëqind euro (500 €), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20€) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë (30€) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr.552/24, e datës 16.01.2025, kundër të pandehurit A.K. nga fshati ..., komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale *Lajmërimi apo kallëzimi i rremë* nga neni 382 par.1 të KPRK -së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri A.K., ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vite, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2024-BD-264, i datës 16.03.2024, Raporti i Oficerit, i datës 25.03.2024,

Procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin R.S. , i datës 25.03.2024, Procesverbal i marrjes në pyetje ankuesit A.K., i datës 25.03.2024, Procesverbal i marrjes në pyetje ankuesit A.K., i datës 26.03.2024, Procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin B.Rr., i datës 26.03.2024, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.K., i datës 27.03.2024, dhe duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale *Lajmërimi apo kallëzimi i rremë* nga neni 382 par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdher ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale,

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr. 18/25, datë 26.02.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.